

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

98341110-9 (Shërbime mirëmbajtjeje).

VLERA E FONDIT LIMIT: 46 666 658 (dyzet e gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë) **lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:
 - a. Sigurimin e ofertës, sipas shtojcës 3;
 - b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DT.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të, duhet të zotërojë Liçenca Profesionale të lëshuar nga institucionet shtetërore kompetente si më poshtë:

- NP - 3 B Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industriale;

- NS - 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve;
- NS - 4 B Punime rifiniturë të muraturës dhe të lidhura me to etj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 2, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “.....Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.....” Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e shërbimeve të pasqyruara në preventiv. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.1.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht shërbime që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së.

2.1.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikatën ISO 45001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e shëndetit dhe sigurisë në punë. Certifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. është kërkuar kjo certifikate pasi ofron një kuadër për menaxhimin efikas të shëndetit dhe sigurisë në punë përfshirë gjithë aspektet e menaxhimit të riskut dhe të përputhshmërisë ligjore nga operatorë ekonomikë, të cilët do të ekzekutojnë këto kontrata shërbimi. Një OE i certifikuar sipas këtij standardi është në gjendje të:

- Krijojë kushtet më të mira të punës në gjithë organizatën e tij;
- Identifikojë kërcënimet dhe vendos kontrollin për menaxhimin e tyre;
- Redukton aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës duke minimizuar kostot dhe kohën Joproductive;
- Përfshin dhe motivon stafin me kushte më të mira dhe më të sigurta pune;
- Dëshmon përputhshmëri ndaj klientëve dhe furnitorëve;

Të gjitha këto janë garanci se OE i shpallur fitues i cili është i certifikuar sipas këtij standardi ka kapacitetet e duhura për realizuar me sukses kontratat me AK-të. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.1.4 Organi i vlerësimit të konformitetit të çertifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 pika 2 c) të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Ky kriter është vendosur në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcaktojnë Ligji nr.116/2014, datë 11.09.2014 "Për akreditimin e organeve të vlerësimit të Konformitetit", Ligji nr.10489 datë 15.12.2011 "Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore", VKM nr. 667, datë 29.7.2015 "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit". Çertifikatat e lëshuara nga ente certifikuese të pa akredituara nuk garantojnë efikasitetin dhe sigurinë për kërkesat e cilësisë të cilat autoriteti kontraktor i kërkon për realizimin e kontratës.

2.1.5 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B "Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e Mbetjeve Urbane", sipas parashikimeve ligjore në Ligjin Nr.9010, datë 13.02.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta"(Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 "Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë") Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 2, 87 pika 2 germa a) të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41 pika 4 gërma a) dhe pika 5 gërma c) e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (të ndryshuar) si dhe në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcakton Ligji Nr.9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (të ndryshuar). Ky kriter synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta, nëpërmjet administrimit mjedisor të tyre në çdo fazë, përfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin, të cilat çojnë në pakësimin e mbetjeve dhe zvogëlimin e ndikimeve të tyre të rrezikshme e të dëmshme. Duke qënë se në preventivin e shërbimeve janë pasqyruar punime prishje është gjykuar se subjekti duhet të ketë lejën e posaçme për veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme ndërtimore. Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e shërbimeve, sipas preventivit ku parashikohen transportim materiale inertesh dhe dhera për shkak të gërmimeve dhe prishjeve. (seksioni III i preventivit).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të çertifikuar nga organet tatimore (nëse nuk është çertifikuar bilanci i Vitit 2021, të dorëzohen bilancet e viteve 2019 dhe 2020). Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, ndërsa kushti që bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar është vendosur në zbatim të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”i ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2019, 2020, 2021) të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Udhëzimin Nr. 7, datë 10.1.2017 “Për disa shtesa në Udhëzimin Nr. 24, datë 2.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar). Në përcaktimin e këtij kriteri është mbajtur në vëmendje neni 29 i Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” (të ndryshuar), ku citohet“Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.... Përcaktimi i vlerës së kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2022 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer shërbime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 40% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara ose vërtetimin për realizimin me sukses të kontratës shoqëruar me faturat tatimore të shitjes, ku të shprehen qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. b) Për shërbime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 47 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është bazuar në nenin 41, pika 3 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i operatorit ekonomik ofertues), Personin Përgjegjës (ose drejtuesin teknik) për kryerjen e shërbimeve (me profesion inxhinier ndërtimi) të shërbimeve në objekte, i cili duhet të figurojë në listëpagesën e subjektit për periudhën Janar 2023 - Shkurt 2023 dhe në vazhdim, dhe të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë pune e vlefshme, Diplomë.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2023 - Shkurt 2023.

Shënim: Ky kriter (2.3.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.3. Operatori ekonomik ofertues për realizimin e kontratës duhet të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesën e subjektit për periudhën Janar 2023 - Shkurt 2023, specialistët si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, i cili duhet të jetë drejtues teknik i shoqërisë.
- 1 (një) Arkitekt.

Për specialistët e lartë të mësipërm duhet të paraqitet:

- Kontratë pune e vlefshme, diplomë.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2023 - Shkurt 2023.

Shënim: Ky kriter (2.3.3) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dëshmi nga administrata tatimore për punësimin mesatar të jo më pak se 147 (njëqind e dyzet shtatë) punonjësve për periudhën Janar 2023 - Shkurt 2023 dhe në vazhdim, të vërtetuar me dokumentacionin si vijon;

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Janar 2023 - Shkurt 2023.
- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2023 - Shkurt 2023.

Shënim: Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës, të pajisur me diploma/çertifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara/ liçensuara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2023 - Shkurt 2023 dhe në vazhdim, minimumi:

- ❖ 18 (tetëmbëdhjetë) punonjës bojaxhi;
- ❖ 8 (tetë) punonjës muratorë/suvatues;
- ❖ 2 (dy) punonjës teknik ndërtimi.
- ❖ 1 (një) punonjës specialist për punime gipsi.

Për këta punonjës, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2023 - Shkurt 2023.
- Kontratën individuale të punës të vlefshme;
- Dokumentacionin që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar në këtë kriter. (diplomë/çertifikatë e arsimit profesional).

Shënim: Ky kriter (2.3.5) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi për pikat 2.3.2, 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5; Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyres se shërbimeve që kërkohen të prokurohen siç janë shërbimet periodike për mirëmbajtjen e objekteve arsimore është e nevojshme pasja e një stafi teknik e vërtetuar kjo në bazë të kodeve të punësimit të profesioneve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”, për realizimin me sukses të kontratës. Punonjësit e kualifikuar janë kërkuar duke u bazuar në numrin e objekteve në të cilat do të kryhen shërbimet si dhe natyrën dhe sasinë e shërbimeve që kërkohen. Me qëllim garantimin e realizimit të kontratës, stafi teknik inxhinierik dhe punonjësit e kërkuar nga autoriteti kontraktor duhet të figurojnë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues. Përcaktimi që punonjësit nuk mund të kontraktohen nga operatori ekonomik ofertues enkas për këtë procedurë prokurimi vjen si rezultat i një përvoje 20-vjeçare të autoritetit kontraktor në fushën e shërbimit të mirëmbajtjes së objekteve arsimore ku kontraktimi për një numër të tillë punonjësish është i pamundur pasi përgjithësisht në kohën kur realizohet ky lloj shërbimi kërkesa e tregut të punës për këta punonjës është e madhe.

2.3.2 Kriteri për të patur në stafin e operatorit ekonomik ofertues drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e shërbimeve. Detyrimi i administratorit të operatorit ekonomik ofertues për të përcaktuar me shkresë Drejtuesin Teknik të shërbimeve objekt të kontratës është bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, pasi për çdo objekt zbatimi duhet të ketë drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij në përputhje me këtë ligj dhe VKM Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

2.3.3 Kërkesa për inxhinierin dhe arkitektin në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjisllacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjisllacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit. Është kërkuar inxhinier ndërtimi për zbatimin e shërbimeve në përputhje me zërat e pasqyruara në preventivit, termave të referencës dhe specifikimeve teknike që do të zbatohen dhe si dhe kategorive përkatëse në licencën përkatëse të zbatimit. Inxhinieri i ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të preventivit për secilin nga zërat e shërbimeve dhe për cilësinë e materialeve që vendosen në objektet ku do të kryhen shërbimet. Është kërkuar arkitekt për faktin që natyra e shërbimeve, për zërat kryesore të preventivit që është lyerja e objekteve, sidomos fasadave të

jashtme të objekteve arsimore, prandaj rezulton se duhet patjetër që përzgjedhja dhe kombinimi i ngjyrave në sipërfaqe relativisht të mëdha të realizohet nga një specialist i kualifikuar.

2.3.4 Për sa i përket përcaktimit të punonjësve të kualifikuar nga institucione të arsimit profesional kjo kërkesë del e nevojshme nga shqyrtimi i preventivit të pasqyruar ku sasia dhe lloji i shërbimeve e bëjnë të domosdoshëm vendosjen e këtij kriteri në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

- a) 18 (tetëmbëdhjetë) punonjës bojaxhinj të kualifikuar janë vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore njëkohësisht në objekte të ndryshme, është gjykuar që të paktën 3(tre) ose 4 (katër) bojaxhinj të kualifikuar duhet të jenë të pranishëm në çdo objekt.
- b) 8 (tetë) punonjës muratorë/suvatues të kualifikuar janë vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore njëkohësisht në objekte të ndryshme sipas grafikut të parashikuar të shërbimeve, është gjykuar që të paktën 1 (një) murator/ suvatues i kualifikuar duhet të jetë i pranishëm në çdo objekt.
- c) 2 (dy) punonjës teknik ndërtimi të kualifikuar janë vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore njëkohësisht në objekte të ndryshme, dhe disa zëra të veçantë të preventivit realizimi i të cilave kërkon staf të specializuar është gjykuar që të paktën 1 (një) teknik ndërtimi i kualifikuar duhet të jetë i pranishëm në çdo objekt ku është i nevojshëm.
- d) 1 (një) punonjës specialist për punime gipsi i kualifikuar është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore njëkohësisht në objekte të ndryshme, është gjykuar që të paktën 1 (një) specialist për punime gipsi i kualifikuar duhet të jetë pjesë e stafit teknik për realizimin e kontratës pasi natyra e punës me gipset kërkon aftësi profesionale të kualifikuara.

2.3.5 Për sa i përket përcaktimit të numrit të përgjithshëm të punonjësve të nevojshëm për realizimin e kontratës jemi bazuar tek zberthimi i zërave preventivit, kohëzgjatja e kontratës dhe përcaktimi i orëve të punës të përlllogaritura në bazë të VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, (e ndryshuar). Këtë përlllogaritje si nevojë e transparencës ndaj ofertuesve po e paraqesim të detajuar si më poshtë:

Nr.	Nr. Analize	Përshkrimi i zërit të punimit	Njësia	Sasia	Orë pune/njësi	Orë pune Total
PER 30 OBJEKTE SHKOLLORE						
A1 - PUNIME BOJATISJE DHE SKELERIE						
1	2.404/1	Boje hidroplastike importi cilesi e larte (lyerje fasade)	m ²	22,778	0.36	8,200.1
2	2.404/1	Boje hidroplastike importi cilesi e larte (lyerje mur rrethues)	m ²	280	0.36	100.8
3	2.404	Boje hidroplastike (lyerje brenda)	m ²	122,525	0.36	44,109.0
4	Analizë	Boje hidromat (lyerje tavane)	m ²	74,134	0.36	26,688.2
8	2.403	Boje vaji mbi siperfaqe te patinuar	m ²	100	0.37	37.0
10	2.431	Skela metalike me tubo per fasade > 12 m	m ²	23,530	0.72	16,941.6
11	2.431	Skela metalike me tubo per fasade ~ 8 m	m ²	4,350	0.72	3,132.0
12	2.429	Skela metalike me tubo per tavan ~ 8 m	m ²	460	1.23	565.8
A2 - PUNIME SUVATIMI E VESHJE ME PLLAKA						
1	2.358/b	Veshje fasade me polisterol kompakt t=5cm+rrjete+suva	m ²	15	5.8	87.0
2	2.358/d	Veshje muri me kartonxhes çimentato	m ²	35	1.5	52.5
3	2.297/a	Tavan me kartonxhes	m ²	5	2.1	10.5
4	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle h ~ 8 m	m ²	950	2.18	2,071.0
5	2.308/a	Suvatim me grafiato h > 4m	m ²	20	3.5	70.0
6	2.328	Patinim muri allçi (stuko)	m ²	2,497	0.76	1,897.7
7	2.330	Patinim tavani allçi (stuko)	m ²	643	1	643.0
A3 - PUNIME TE NDRYSHME E PRISHJE						
1	60% puntori e An 2.358/b	Prishje veshje fasade me polisterol	m ²	12.00	5.8	69.6
2	60% puntori e An 2.331	Prishje suva e zakonshme fasade mur tulle h ~ 8 m	m ²	480.00	2.18	1,046.4
3	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m ³	7.00	2.0	14.0
SHUMA GJITHSEJ ORË PUNE A=A1+A2+A3						
						105,736.2

		Ore pune ne total per kryerjen e sherbimit (referuar normative sipas Manualit Teknik)			105,736
		Dite pune 8 orarëshe ne total per kryerjen e sherbimit	ore pune Total/8 ore ne dite =		13,217
		Periudha në ditë e kryerjes se sherbimit eshte 1 qershor- 15 shtator	26 dite pune ne muaj*3.5 mua j=		91
		Numri i fuqise punetore per kryerjen e sherbimit per 91 dite	13,217 Dite pune total /91dite =		145
		Gjithsej fuqia punëtore e nevojshme për realizimin e kontratës 145 punonjës + 2 specialistë të lartë =			147

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 1(një) punonjës i cili të jetë i pajisur me çertifikatën e trajnimit si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" ose ekuivalente dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën Janar 2022 - Shkurt 2022 dhe në vazhdim, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për punonjësën e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe dëshmia përkatëse e lëshuar nga ente çertifikuese të akredituara/liçensuara.

Shënim: Ky kriter (2.3.6) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 pika 4, nenin 76 pika 3 germa a) të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 5 germa c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", i cili përcakton se..... Neni 7....Shërbimet e mbrojtjes dhe të parandalimit....1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion..., dhe V.K.M nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e e rregullores për sigurinë në kantier". Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çenojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 4 (katër) punonjës të cilët të jenë pajisur me çertifikatën e trajnimit "Për punimet në lartësi" ose ekuivalente, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" dhe të figurojë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën Janar 2022 - Shkurt 2022 dhe në vazhdim. Për punonjësën e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe dëshmia përkatëse e lëshuar nga ente çertifikuese të akredituara/ liçensuara.

Shënim: Ky kriter (2.3.7) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 pika 4, nenin 76 pika 3 germa a) të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 5 germa c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", i cili përcakton se..... Neni 7....Shërbimet e mbrojtjes dhe të parandalimit...1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion.....2. Në përputhje me pikën 1 të këtij neni:.....c) punëmarrësit/ punëmarrësve i/u sigurohen nga punëdhënësi mjetet dhe trajnimi i nevojshëm për të realizuar detyrimet që rrjedhin nga ky ligj....., dhe V.K.M nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier". Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësi i cili është i çertifikuar si "Për punimet në lartësi" ose ekuivalente nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë punimeve në lartësi dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi. Duke iu referuar preventivit të pasqyruar në DST parashikohen ngritje skelash dhe punime në to në lartësi nga 8m deri 12 m me një sipërfaqe totale prej 9730 m².

2.3.8 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues për materialet (bojë hidroplastike, bojë hidroplastike cilësi e lartë, hidromat, bojë vaji, kartonxhes çimentato, kartonxhes i brendshëm, Ilaç i gatshëm, grafiato, stuko patinimi, sistem kompozit termoizolues i jashtëm), të pasqyruara në Shtojcën 5 "Formulari i specifikimeve teknike", duhet të paraqesë: Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve lëshuara/publikuara nga prodhuesit/ distributorët zyrtarë ose skedat teknike të lëshuara/publikuara nga prodhuesit/distributorët zyrtarë, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike

të mallrave sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse mallrat e ofruara të cilat do të përdoren në kryerjen e shërbimeve, plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të cilat janë të domosdoshme në realizimin e shërbimeve objekt prokurimi. Në këtë rast është shumë e rëndësishme plotësimi i specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor pasi kemi të bëjmë me produkte të cilat domosdoshmërisht duhet të garantojnë cilësinë e kërkuar dhe funksionalitetin gjatë përdorimit të tyre në kryerjen e punimeve të ndryshme specifike pasi përdoren në objekte arsimore ku kërkesat e cilësisë dhe të ruajtjes së mjedisit janë të larta.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatë Konfirmimit CE ose Çertifikatë Ecolabel ose raportet e testimi, të lëshuara nga ente certifikues të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë për produktet objekt prokurimi të cilat do të përdoren në shërbimet e mirëmbajtjes të parashikuara sipas preventivit të publikuar, për të cilët janë kërkuar standarte teknike kombëtare apo ndërkombëtare të miratuara, të specifikuara në Shtojcën 5 Specifikimet Teknike, me qëllim vërtetimin e përmbushjes standarteve teknike të kërkuara.

Shënim: Ky kriter (2.3.9) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose *nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.*

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/ c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe Ligji nr.9779, datë 16.07.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi të testeve zyrtare të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit. Materialet që do të përdoren për mirëmbajtjen dhe lyerjen e objekteve arsimore duhet të jenë ekologjike, cilësore dhe të padëmshme për shëndetin e fëmijëve. Në bazë të rregullave të vendosura nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.907, datë 21.12.2016 “Për kufizimin e shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa bojëra, llaqe dhe produkte për lustrimin e mjeteve”, këto produkte duhet të kenë përmbajtje sa më të ulët të përbërësve organikë të avullueshëm (të çlirojnë sa më pak të jetë e mundur), pigmentet të jenë në përputhje me kriteret ekologjike, të mos përmbajnë metale të rënda apo substanca toksike, të kenë një mbulueshmëri të mirë dhe të jenë

rezistenete ndaj faktorëve atmosferikë të brendshëm dhe të jashtëm. Bojrat e përdorura për lyerje të ambienteve të brendshme dhe të jashtme përmbajnë kimikate, të cilët deri më së fundmi janë të rëndësishme për cilësinë dhe karakteristikat e bojës. Ato ndihmojnë në lidhjen e komponenteve, në qëndrueshmërinë dhe në normën e përhapjes së saj. Këto kimikate, të tilla si amoniaku apo solvente të avullueshëm, të quajtur VOCs, kur boja thahet avullojnë, çlirohen nga cipa e tharë e bojës dhe qëndrojnë në ajrin e ambientit të lyer. Ato janë potencialisht të dëmshme, pasi personat që popullojnë këto ambiente thithin ajrin e ngopur me këto avuj. Ato shkaktojnë simptoma akute, duke përfshirë dhimbje koke, të vjella, probleme në rrugët e frymëmarrjes, alergji, etj. Prandaj autoriteti kontaktor e gjykon se këto produkte duhen të jenë të çertifikuara nga organizma çertifikues të akredituar.

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacion për posedimin e mjeteve/ pajisjeve teknike dhe mbrojtëse në pronësi ose me qira, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës, minimumi për mjetet/ pajisjet teknike dhe mbrojtëse si më poshtë;

Nr.	Kreu I - Mjetet dhe pajisjet teknike	Sasia minimale	Gjendja
1	Kamion me vinç për transportimin e skelave	1 copë	Pronësi ose me qira
2	Kamion 3.5 - 7.5ton	1 copë	Pronësi ose me qira
3	Automjet me kosh në lartësi $\geq 12m$	1 copë	Pronësi ose me qira
4	Skeleri metalike	5000 m ²	Pronësi ose me qira
5	Karrocë dore $\geq 80lt$	2 copë	Pronësi ose me qira
Nr.	Kreu II - Mjetet dhe pajisjet mbrojtëse	Sasia minimale	Gjendja
1	Helmetë mbrojtëse për kokën	147 copë	Pronësi ose me qira
2	Jelekë me shirita fosforishentë	147 copë	Pronësi ose me qira
3	Fikëse zjarri të lëvizshme $\geq 5kg$	4 copë	Pronësi ose me qira
4	Tabela Sigurimi Teknik	20 copë	Pronësi ose me qira
5	Kuti e Ndihmës së shpejtë	4 copë	Pronësi ose me qira

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme), kurse për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqitet me kontrata përkatëse e qerasë/furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme).
- b) Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe kur ato janë të marra me qera të paraqitet

kontrata e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj si edhe dokumentat që vërtetojnë pronësinë e qiradhënënesit si aktet e zhdoganimit/ faturat tatimore të blerjes.

- c) Mjetet, pajisjet teknike dhe mjetet mbrojtëse të mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera gjatë afatit kohor të zbatimit të kontratës objekt të këtij prokurimi. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë brenda orarit të punës, në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës, mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr.9.

Shënim: Ky kriter (2.3.10) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë shërbimet për lyerjen dhe mirëmbajtjen periodike të objekteve arsimore, të cilat duhet të realizohen sipas specifikimeve teknike, duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, makineritë dhe pajisjet mbrojtëse të përcaktuara më sipër. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme zotërimi i këtyre pajisjeve specifike, të konsideruar nga Autoriteti kontraktor si të domosdoshme për realizimin e shërbimit në përputhje me ligjislacionin e punës. Referuar natyrës së objektit të prokurimit për realizimin me sukses të shërbimeve është e nevojshme pajisja e këtyre mjeteve teknike.

1) Kamion me vinç për transportimin e skelave, është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës, sasinë prej minimumi 5000 m² skeleri dhe shpërndarjen e 30 objekteve arsimore, është gjykuar që të paktën 1 (një) mjet i tillë është i nevojshëm për zbatimin e kontratës.

2) Kamion 3.5-7.5ton, është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës, sasinë e produkteve të nevojshme për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e 30 objekteve arsimore, është gjykuar që të paktën 1 (një) mjet i tillë është i nevojshëm për zbatimin e kontratës.

3) Automjet me kosh në lartësi $\geq 12m$, është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh se disa nga objektet arsimore janë të pozicionuara në disa pjesë të tyre në pamundësi për vendosjen e skelerisë në lartësi, është gjykuar që të paktën 1 (një) mjet i tillë është i nevojshëm për zbatimin e kontratës.

4) Karrocë dore ≥ 80 lt, është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës, sasinë e produkteve të nevojshme për realizimin e kontratës, sasinë e mbeturinava inerte që duhen transportuar nga objektet nëpër vendgrumbullimet provizore të kantierit dhe shpërndarjen e 30 objekteve arsimore, është gjykuar që të paktën 2 (dy) pajisje teknike të tilla janë të nevojshme për zbatimin e kontratës.

5) Për të realizuar me efikasitet mbrojtjen dhe sigurinë në punë për punonjësit e nevojshëm për realizimin e kontratës janë kërkuar këto mjete mbrojtëse të pasqyruara në Kreun II të Tabelës në pikën 2.3.12, në përputhje me natyrën e shërbimeve dhe numrin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e kontratës dhe kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm, i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve të teknike në përputhje me nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Qëllimi i Shërbimit të Iyerjes: Bojatisje, higjenizimi, pastrimi dhe ripërtëritje e ngjyrave në sipërfaqet e mureve të brendëshme dhe të jashtëme të objekteve shkollore.

Objekti i Shërbimit të Iyerjes: Të mundësojë Iyerjen me cilësi dhe në kohë, duke përdorur bojra e materiale ekologjike dhe të standartizuara, në objektet shkollore të Bashkisë Tiranë, të sipërfaqeve të mureve të brendëshme e të jashtëme dhe tavanet, sipas listës së objekteve të sipërcituar.

Kontrata zbatohet me plane të programuara mujore duke mbajtur kontakte të përditshëm me përfaqësues të AK të ngarkuar për ndjekjen e procedurës së zbatimit të kontratës, procedurë me të cilin OE njihet zyrtarisht nga AK me fillimin e zbatimit.

Të gjitha materialet bojatisëse dhe të riparimit si: bojë hidroplastike inporti cilesi e larte, bojë hidroplastike, bojë hidromat, astar, bojë vaji, stuko patinimi, duhet të jenë të çertifikuara konform standartit (CE) dhe të detyrueshme për t’u zbatuar nga ofertuesi. Në vijim po argumentojmë specifikimet teknike të nevojshme për materialet sipas zerave të punës në preventiv.

Mallrat që do të përdoren për kryerjen e shërbimeve duhet të jenë të shoqëruara me garancitë përkatëse (të përcaktuara në DST dhe në kontratë) në marrëveshjen e përcaktimit të kushteve të garancisë, para lidhjes së kontratës do të definohen dhe mënyrat, koha, dhe çdo specifikim tjetër i vlefshëm dhe i detyrueshëm për palët kontraktuese. Përzgjedhja e specifikimeve teknike të bojërave dhe produkteve të tjerë të nevojshëm për realizimin e kontratës është bërë duke u bazuar tek standarti i bojërave të ofruara sipas kontratave të mëparshme gjatë viteve dhe nevojave reale të institucionit për llojin, sasinë dhe cilësinë e bojërave duke patur parasysh se këto bojëra përdoren në ambiente shkollore dhe parashkollore ku patjetër duhet të përmbushen standartet teknike të

konfirmimetit për cilësinë dhe ndikimin në mjedis. Materialet do të përdoren për mirëmbajtjen e objekteve arsimore, prandaj ato duhet të jenë ekologjike, cilësore dhe të padëmshme për shëndetin e fëmijëve.

Në bazë të rregullave të vendosura nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.907, datë 21.12.2016 “Për kufizimin e shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa bojëra, llaqe dhe produkte për lustrimin e mjeteve”, këto produkte duhet të kenë përmbajtje sa më të ulët të përbërësve organikë të avullueshëm (të çlirojnë sa më pak të jetë e mundur), pigmentet të jenë në përputhje me kriteret ekologjike dhe të mos përmbajnë metale të rënda apo substanca toksike.

Bojrat e përdorura për lyerje të ambienteve të brendshme përmbajnë kimikate, të cilët deri më së fundmi janë të rëndësishme për cilësinë dhe karakteristikat e bojës. Ato ndihmojnë në lidhjen e komponenteve, në qëndrueshmërinë dhe në normën e përhapjes së saj. Këto kimikate, të tilla si amoniaku apo solvente të avullueshëm, të quajtur VOCs, kur boja thahet avullojnë, çlirohen nga cipa e tharë e bojës dhe qëndrojnë në ajrin e ambientit të lyer. Ato janë potencialisht të dëmshme, pasi personat që popullojnë këto ambiente thithin ajrin e ngopur me këto avuj. Ato shkaktojnë simptoma akute, duke përfshirë dhimbje koke, të vjella, probleme në rrugët e frymëmarrjes, etj .

Përmbajtja e VOCs (komponentët organikë të paqëndrueshëm) në bojra dhe materialet e tjera për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm, është e rregulluar, nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.907, datë 21.12.2016 “Për kufizimin e shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa bojëra, llaqe dhe produkte për lustrimin e mjeteve”. Ky vendim, përshkruan limitin e emetimit të përbërësve organike të avullueshëm nga bojërat. Ky legjislacion detyron prodhuesit e bojërave të prodhojnë produkte që të garantojnë cilësi për ajrin e ambienteve të brendshëm. Dhe për këtë ato duhet të testojnë produktet e tyre, nga laboratorë të certifikuar, që tregojnë përmbushjen e këtyre kufizimeve në lidhje me limitimin e emetimit të VOCs (komponentët organikë të paqëndrueshëm) në ajrin e brendshëm të ambienteve.

Testimet duhet të kryhen sipas standartit SSH ISO 11890-2 ose ekuivalentit të tij për monitorimin e nivelit të çlirimit të VOCs në ajrin e ambientit të brendshëm dhe të jashtëm për produktet bojëra dhe llaqe dhe komponentëve ndihmës si astari etj. do të na ndihmojë të vlerësojmë për cilësinë e tyre dhe përmbushjen e normave të kërkuara. Veçanërisht boja plastike duhet të ketë performancë të mirë, të ketë normë të lartë përhapje dhe të jetë pa erë.

Për shkak të përdorimit të bojës plastike në ambiente kopshtesh, çerdhesh dhe shkollash, ku higjiena duhet të jetë e lartë, duhet që boja plastike të jetë e lashme dhe të ketë aftësi të mira për pastrimin e saj. Prandaj produkti duhet të shoqërohet me certifikatë/raport testimi, nga një ent certifikues i akredituar, që ai plotëson Standartet Teknike Shqiptare SSH EN ISO 11998:2006 lidhur me rezistencën në fërkim të lagësht dhe aftësia për t’u pastruar e veshjeve/shtresave të holla të lyerjes, SSH EN ISO 6504-3:2007, lidhur me aftësinë mbuluese (fshehëse) të bojës ose ekuivalentët e tyre dhe standarte të tjera teknike sipas produktit të kërkuar.

Për sa i përket kriterëve teknike të aftësisë së shtrirjes së bojës, ato janë të përcaktuar në nivel teorik pasi në praktikë kjo ndryshon nga shumë faktorë të cilat ndikojnë në normën e sipërfaqes së mbulimit siç janë; poroziteti, ashpërsia, parregullsia, aftësia e përthithjes së materialit e sipërfaqeve që do të lyhen, mënyra e aplikimit të bojës dhe destinacioni për të cilën do të përdoret. Këto përcaktime janë në pothuaj të gjitha web-sitet zyrtarë të operatorëve ekonomikë prodhues botërorë ku përcaktohet i njëjti qëndrim për standartin e parashikimit të aftësisë mbuluese të bojërave.

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 5 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.**

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT